

## **SURETU ESH SHEMS KAPTINA 91**

*E zbritur në Meke, pas sures El Kadri, ajete: 15*

*Zoti xh. sh. betohet në shtatë krijesa me rëndësi se njeriu që ruhet dhe iu përmbahet porosive të Zotit është i shpëtar, e ai që është rrebel do të jetë i mjeruar. Prandaj, e tërë kjo sure flet rrëth çështjes së njeriut.*

*Quhet: “**Suretush Shemsi**”, ngase në nismë të saj bëhet betimi në diellin.*

---


## **SURETU EL LEJL KAPTINA 92**

*E zbritur në Meke, pas sures El A'ëla, ajete: 21*

*Në këtë sure bëhet fjalë rrëth përpjekjeve të njeriut në këtë jetë dhe rrëth përfundimit të tij në jetën tjetër, në xhennet a xhehenem.*

*Në fillim jepet betimi në natën, ditën dhe në Krijuesin, e më pas një sqarim përrugën që çon në fatbardhësi dhe për atë që çon në vuajtje, duke bërë me dije se mashtrimi pas pasurisë së grumbulluar, nuk bën dobi në ditën e kijametit. Përmend rrugën e besimtarit të mirë, i cili jep nga pasuria e vet për hir të Zotit, e si shembull është Ebu Bekri.*

*Quhet: “**Suretul Lejli**” kaptina e natës, ngase në fillim bëhet betimi në natë.*



## SURETU ESH SHEMS

*Me emrin e Allahut, Mëshiruesit,  
Mëshirëberësit!*

1. Pasha diellin dhe dritën e tij!
2. Pasha hënën kur vjen pas tij!
3. Pasha ditën kur ai (*dielli*) e shndrit!
4. Pasha natën kur ajo e mbulon atë (*dritën e diellit*)!
5. Pasha qellin dhe Atë që e ndërtoi atë!
6. Pasha tokën dhe Atë që e shtriu atë (*e sheshoi*)!
7. Pasha njeriun dhe Atë që e krijoj atë!
8. Dhe ia mësoi se cilat janë të këqijat dhe të mirat e tij.

\* Betimi në diellin ka rëndësi të madhe, sepse kur ai largohet, bota mbetet si e vdekur, e kur lind dhe jep dritën, kthehet jeta dhe, në kohën kur ai pak ngritet e i thuhet "duha", njerëzit ia fillojnë punës. E kjo koha e duhasë i përgjanë ditës së kijametit, ngase banorët e xhennetit në atë kohë do të zënë vend aty.

Në gjysmën e parë të ndërrimit të saj, edhe hëna e vazhdon dritën pas diellit.

9. Pra, ka shpëtar ai që e pastroi veveten.

10. E ka dështuar ai që e poshtëroi veveten.

11. Themudi përgënjeshtri për shkak të arrrogancës së vet.

12. Kur më i keqi i tyre u ngrit me të shpejtë.

13. E Pejgamberi atyre u pat thënë: "Kinie kujdes devenë e Allahut dhe ndaj pengimit të saj që të pijà ujë.

14. Ata nuk i besuan atij dhe atë (devenë) e therën dhe Zoti i tyre për shkak të mëkatit të tyre ua rreshtoi ndëshkimet dhe i rrafshoi,

15. Duke mos i frikësuar prapavisë së atij (*ndëshkimi*).\*

## SURETU EL LEJL

*Me emrin e Allahut, Mëshiruesit,  
Mëshirëberësit!*

1. Pasha natën që me errësirë mbulon gjithësinë?

2. Pasha ditën kur ajo shkreptin!

3. Pasha Atë që krijoj mashkullin e femrën!

4. Vërtet, veprimi juaj është i llojillojtë.

5. E, sa i përket atij që jep dhe ruhet.

6. Dhe vërteton bindshëm pér më të mirën,

7. Ne do ta përgatitum atë pér më të lehtën.

8. E sa i përket atij që bën kopraci dhe ndien veten të pavarur (*nga Zoti*),

9. Dhe që përgënjeshtron atë më të mirën,

10. Ne do ta përgatisim pér më të vështirën.

11. E pasuria e tij nuk do t'i bëjë dobi, kur ai të zhduket.

12. Detyrë jona është vetëm të udhëzojmë.

13. Dhe vetëm Jona është bota tjetër si dhe kjo.

14. Unë u kam tërhequr vërejtjen pér zjarrin të ndezur fort.